



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 176, Datë 23.08.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SH.P.K., PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërmat “a” dhe “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërmat “a” dhe “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjise Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.08.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/3 prot., datë 16.08.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Terfoja dhe veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HEC TERFOJA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879 prot., datë 11.08.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga aplikimi i shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., vërehet se nuk është kryer pagesa e aplikimit për licencim për këtë veprimtari në zbatim të Aneksit A, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe është përcjellë kryesisht dokumentacion për nevoja të këtij aplikimi.
- Bazuar në nenin 8, pika 1 dhe 2, dhe në nenin 9, pika 3, gërma “d”, e Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjise Elektrike, duke qenë se nuk është kryer pagesa e aplikimit për licencim për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, atëherë dhe dokumentacioni i depozituar nuk mund të merret në shqyrtim nga ana e ERE-s.
- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga ai për aplikimin e

mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur edhe pagesën e aplikimit për licencim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI